



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 8142 Prot.

Tiranë, më 07.11.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1582, datë 17.10.2012.

**SHOQËRISË "TUR-ALB-KROM" SH.P.K
Rruga "Egnatia", Lagjja 3, Kati 7, Durrës.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "TUR-ALB-KROM" sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1582, datë 17.10.2012, për mineralin krom, në Objektivin "Lugjas, Malzi", Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.4475, datë 24.10.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.8142. Prot, datë 26.10.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1582, datë 17.10.2012, për mineralin krom, në Objektivin "Lugjas, Malzi", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, ku nga kontrolli në objekt u konstatua se subjekti nuk ka zhvilluar aktivitet minerar për më shumë se një vit kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma "c" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1582, datë 17.10.2012, për mineralin krom, në Objektivin "Lugjas, Malzi", Bashkia Kukës, Qarku Kukës që shoqëria juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftimin për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim rreth revokimit të Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1582, datë 17.10.2012, për mineralin krom, në Objektivin "Lugias, Malzi", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, nenin 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

